



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 92, DATË 08.10.2020

PËR  
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SUBJEKTIT PERSON FIZIK RAHMAN  
MEKOLLARI, AUTORIZUAR PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË  
PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË RRJET  
KABLLOR “TV KABLLOR KRISTAL”, PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË OFRIMIT  
TË SHËRBIMIT NË “NJËSINË ADMINISTRATIVE LIBRAZHD”

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kërkues: Subjekti person fizik Rahman Mekollari

Objekt: Shqyrtimi i aplikimit të të subjektit person fizik Rahman Mekollari, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Kristal”, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në “Njësinë Administrative Librazhd”.

Baza Ligjore: Neni 19, pikat 1/b dhe 16, neni 64, pika 5 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, subjekti person fizik Rahman Mekollari, ka depozituar aplikimin nr. 1713 prot., datë 25.06.2020, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Kristal”.

Ky aplikim u shqyrtua nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD) ngritur me urdhërin e Kryetarit të AMA-s, nr. 109, datë 02.07.2020, të Kryetarit të AMA-s, dhe duke qenë se aplikimi rezultoi me mangësi në dokumentacionin juridik, programor, të së drejtës së

transmetimit, teknik dhe organizativ, AMA kërkoi nga subjekti plotësimin e dokumentacionit për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit.

Në vijim, subjekti person fizik Rahman Mekollari depozitoi dokumentacionin shtesë me nr. 2265 prot., datë 17.08.2020 dhe nr. 2266 prot., datë 17.08.2020, dokumentacioni i cili u shqyrtua nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, ngritur me urdhërin e Kryetarit të AMA-s nr. 142, datë 18.08.2020.

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit plotësues, KSHD vlerësoi se aplikimi i subjektit person fizik Rahman Mekollari i plotëson kriteret juridike, financiare, teknike, të së drejtës së transmetimit, programore dhe organizative, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Kristal" duke i propozuar AMA-s, pranimin e aplikimit dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit në "Njësinë Administrative Librazhd".

AMA vëren se për pranimin e aplikimit dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit, që në thelb nënkupton marrje autorizimi për një zonë të re të shtrirjes së aktivitetit audioviziv, nevojitet shumicë e cilësuar, pasi në nenin 19, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 97/2013, të sipërcituar, parashikohet: "AMA ... lëshon dhe heq licencat dhe/ose autorizimet me shumicë të cilësuar;..." Në nenin 13 të ligjit organik, parashikohet se: "2. Vendimet e AMA-s merren kur për to votojnë pro shumica e anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj".

AMA është organ kolegjal i përbërë nga kryetari dhe 6 anëtarë, që aktualisht funksionon me 5 anëtarë dhe për të miratuar dhënien e autorizimit, nevojitet një kuorum prej 5 votash, kuorum i cili nuk u plotësua gjatë votimit të aplikimit të subjektit person fizik Rahman Mekollari, në kushtet kur 3 anëtarë votuan pro dhe 2 anëtarë votuan kundër aplikimit të subjektit,

### **PËR KËTO ARSYE**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pikat 1/b dhe 16, nenit 64, pika 5 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e aplikimit të subjektit person fizik Rahman Mekollari, për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në "Njësinë Administrative Librazhd", për shkak të mosarritjes së kuorumit të nevojshëm ligjor.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar:</b>	<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>
<b>Zëvendëskryetar:</b>	<b>Sami</b>	<b>NEZAJ (Kundër)</b>
<b>Anëtarë:</b>	<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>
	<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI (Kundër)</b>
	<b>Suela</b>	<b>MUSTA (Kundër)</b>